



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 48, datë 20 .11. 2012

**PËR
“MIRATIMIN E “PROJEKTIT TË SHËRBIMIT KËSHILLIMOR PËR
MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA PËR QYTETIN E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/VI, gërma “a”, nenit 10, pika 3, nenit 19 dhe nenit 32, pika “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 6 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr.10463, datë 22.09.2011, për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Te miratojë projektin “Shërbimi Këshillimor për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta për Qytetin e Tiranës”, bashkëfinansim nga Koorporata Ndërkombëtare Financiare dhe Bashkia e Tiranës, në shumën totale prej 800 000 (tetëqind mijë) USD.
2. Të miratojë shumën prej 120 000 (njëqind e njëzet mijë) USD, si detyrim që rrjedh nga marrëveshja e bashkëfinansimit të konsulencës me Koorporatën Ndërkombëtare Financiare, e cila synon përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe induksionin në këtë shërbim të sektorit privat në qytetin e Tiranës.
3. Efektet financiare të Bashkisë së Tiranës, për shumën prej 120 000 (njëqind e njëzetë mijë) USD, sipas fazave të projektit do të parashikohen në buxhetin e vitit 2013.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI